



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 4 Datë 21.01.2013

PËR

**HEQJEN E LICENSAVE TË SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A,
PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISE ELEKTRIKE,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 08, DATE 25.01.2008, TE
NDRYSHUAR, DHE PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME
PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE” TË MIRATUAR ME
VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 09, DATË
25.01.2008, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma a), 9 dhe 18 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të Shqipërisë, të miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008; “Deklarates Rregullatore” miratuar me Vendimin nr. 12, datë 03.03.2009, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të Rregullores për Heqjen e Liçensave, miratuar me Vendimin nr. 68, datë 04.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; Liçensës “Për aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike” miratuar me Vendimin nr. 09, datë 25.01.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; Liçensës për aktivitetin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin nr. 08, datë 25.01.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjare dhe Jo-Familjare, miratuar me Vendimet nr. 108 dhe 109, datë 21.10.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; Kontrates së Furnizimit me Energji Elektrike me KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje, të miratuar me Vendimin nr. 31, datë 31.03.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE; Marrëveshjes së Transmetimit mes OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje miratuar me Vendimin 03, datë 11.01.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE dhe nenit 18 pika 1 gërma a) të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.01.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike

për heqjen e liçensës së shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a në aktivitetin e shpërndarjes dhe Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike,

Vendosi :

1. Heqje te licenses se aktivitetit te shperndarjes se energjise elektrike shoqerise CEZ Shperndarje sh.a;
2. Heqje te licenses se aktivitetit furnizimit publik me pakice te energjise elektrike shoqerise CEZ Shperndarje sh.a;
3. Shoqeria CEZ Shperndarje eshte pergjegjese per kostot e shkaktuara ERE-se, Qeverise Shqiptare dhe pjesmarresve te tregut, si rezultat i heqjes se licensave ne perputhje me piken 5.6 te licenses se shperndarjes s energjise elektrike dhe pikes 5.6 te licenses se furnizimit publik me pakice;
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje menjehere Keshillin e Ministrave per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE, qe te veproje per shpronësimin e asetëve te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a, sipas procedurave te parashikuara ne ligjin nr.8561, date 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.
5. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje menjehere CEZ Shperndarje per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.